

V E N D I M

Nr.596, datë 21.9.1998

PËR MBYLLJEN E ZYRAVE TË HIPOTEKAVE DHE PËR KALIMIN E VEPRIMTARISË SË TYRE NË ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 56 e 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrat e hipotekës mbyllen dhe veprimtaria e tyre të realizohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve.

Zyrat e hipotekave hiqen nga struktura e Ministrisë së Drejtësisë duke pakësuar organikën përkatëse.

Objektet, ndërtesat dhe mjediset pronë shtetërore, që kanë pasur në përdorim zyrat e hipotekave, mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë për t’u përdorur si zyra të përmbarimit ose dhe për veprimtari të tjera të kësaj ministrie.

2. Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të marrin masa për transferimin e dokumenteve të zyrave të hipotekës, duke siguruar respektimin e rregullave për dorëzimin e tyre.

3. Në zbatim të këtij vendimi, Ministri i Drejtësisë me urdhër të veçantë përcakton:

3.1. Punonjësit e hipotekave, të cilët sipas numrit të propozuar nga kryeregjistruesi, do të vazhdojnë veprimtarinë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e regjistrimit fillestar, duke lidhur kontratë pune të kushtëzuar me afatin e mësipërm, përveç kur mbahen për plotësimin e vendeve vakante.

3.2. Punonjësit e hipotekave, të cilët ndërpresin marrëdhëniet e punës për shkak të mbylljes së veprimtarisë.

3.3. Destinacionin e mjeteve të punës që mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë.

3.4. Mënyrën e veprimit me ndërtesat dhe mjediset e zyrave të hipotekave, që nuk janë pronë shtetërore.

4. Nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë pakësohet fondi i pagave dhe i shpenzimeve të tjera të planifikuara për zyrat e hipotekave për vitin 1998, në pjesën e papërdorur deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Nga vlerat e mësipërme në buxhetin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, shtohet pjesa proporcionale, e cila i korrespondon numrit të punonjësve të hipotekave, që do të aktivizohen me kontratë, ndërsa pjesa tjetër i kalon Buxhetit të Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.303, datë 16.4.1996 pika 2, nr.426, datë 17.6.1996, nr.676, datë 14.10.1996, nr.580, datë 22.12.1997, nr.174, datë 18.4.1995, pika 4, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Nano

Fatos